

Afrim Osmani, PhD<sup>1</sup>

Hankush Osmani, MA candidate<sup>2</sup>

UDC:

316.663.2-055.2

**PJESËMARRJA INSTITUCIONALE E GRUAS NË BALLKAN –  
SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT**

**ИНСТИТУЦИОНАЛНО УЧЕСТВО НА ЖЕНАТА ВО  
БАЛКАНОТ – ПРЕДИЗВИЦИ И ПЕРСПЕКТИВИ**

**INSTITUTIONAL PARTICIPATION OF WOMEN IN  
THE BALKANS - CHALLENGES AND PERSPECTIVES**

**1. Abstract**

Thanks to the democratic processes, which result from aspiration for integration of Balkan countries into Euro-Atlantic structures, also imposed new rules regarding decision-making and institutional participation in women, in which processes and woman is envisaged as an integral part as well.

When it's talking about the gender equality mainly meant to advance the position of women in society, especially in public life and in decision-making positions. Gender equality means "equal participation of women and men in all areas of life, equal footing, equal opportunities to enjoy all their rights and to put into service their individual potentials in the development of society as well as equal benefit from the results of this development.

Gender equality in political participation is a fundamental aspect of modern democratic governance. According to international standards, men and women should have equal rights and opportunities for

---

<sup>1</sup> Ligjërues në fakultetin juridik pranë Universitetit të Tetovës.

<sup>2</sup> MA candidate at philosophic faculty – University of Tetova (branch of sociology).

full participation in all aspects and levels of political processes. However, in practice it is much more challenging for women to enjoy and exercise these rights.

The rate of women's participation in politics and their access to decision-making can be considered as the main indicator of gender equality in a society. Percentage of seats occupied by women in parliament, clearly helps to judge a country's democracy. Gender equality in decision-making should be viewed in a context that women are able to obtain or influence public decisions the same way as men. Although women make up nearly half the population of a state, it is unimaginable to their low participation in political and public life. Normally, in a country where almost 50% of the population consists of feminine, participation in decision-making positions of gender should be in the same quota.

**Keywords: institutional participation, gender equality, gender non-discrimination, gender justice, etc.**

## 2. ASPEKTI KOMPARATIV

Nëse bëjmë një krahasim të shkurtër me vendet që e rrethojnë Maqedoninë, por edhe më gjerë, do të shohim se vendi ynë është shumë mbrapa, edhe pse kohëve të fundit Maqedonia fillojë ta ndryshojë këtë kurs.

Politika për barazi gjinore dhe fuqizim të grave paraqet një nga parimet fundamentale të demokracisë dhe rregullimit shoqëror. Barazia gjinore është e garantuar me konventa ndërkombëtare, Kushtetutën si akti më i lartë juridik i shteteve, ligjet përkatëse, në veçanti Ligji për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave, etj.

### *2.1. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave – miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën 34/180 të datës 18 dhjetor 1979<sup>3</sup>*

**Neni 2:** Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave dhe për këtë arsye zotohen: (a) Të përfshijnë në kushtetutat e tyre kombëtare

---

<sup>3</sup> Shih Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave – miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën 34/180 të datës 18 dhjetor 1979.

ose në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme, parimin e barazisë së burrit dhe të gruas, po qe se ende nuk është bërë, ta sigurojnë nëpërmjet legjislacionit dhe masave tjera të përshtatshme zbatimin praktik të këtij parimi.

### ***2.2. Konventa evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut<sup>4</sup>***

**NENI 14 :** Ndalimi i diskriminimit, gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

### ***2.3. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë<sup>5</sup>***

#### **Neni 9:**

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore. Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve.

### ***2.4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>6</sup>***

**Neni 15:** Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik.

**Neni 18:** Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

### ***2.5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës<sup>7</sup>***

**Neni 7, paragrafi 2:** Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë,

---

<sup>4</sup> Shih **Konventa evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.**

<sup>5</sup> Shih Pollozhani, dr. Bajram (2011), “Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës”, f.28.

<sup>6</sup> Shih Pollozhani, dr. Bajram (2011), “Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës”, f.92 dhe 93.

<sup>7</sup> Shih Pollozhani, dr. Bajram (2011), “Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës”, f.152 dhe 179.

mundësi të barabartë për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fushat e tjera shoqërore.

**Neni 71, paragrafi 2:** Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektojë parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare.

Përveç kësaj, janë miratuar edhe **ligje të veçanta** që rregullojnë trajtimin e barabartë në mes femrave dhe meshkujve, siç është ligji për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve.

Shkelja e barazisë gjinore në këtë drejtim trajtohet edhe si vepër penale. Kështu për shembull, sipas kodit penal të RM-së diskriminimi gjinor parashihet si vepër penale, çështje të cilën e rregullon neni 137.

**Neni 137: Shkelja e barazisë së qytetarëve<sup>8</sup>**

Ai i cili në bazë të dallimit të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, familjes, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit apo bindjes fetare, formave tjera të bindjes, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal apo shoqëror, pengesës mentale apo trupore, moshës, gjendjes familjare apo martesore, statusit pasuror, gjendjes shëndetësore apo kujtudo qoftë baze tjetër e paraparë me ligj apo marrëveshje e ratifikuar ndërkombëtare, do t'i merr apo kufizojë të drejtat njeriut apo qytetarit të përcaktuara me Kushtetutën, ligjin apo marrëveshjen e ratifikuar ndërkombëtare ose i cili në bazë të këtyre dallimeve u jep qytetarëve privilegje në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjin apo marrëveshjen e ratifikuar ndërkombëtare, do të dënohet me burgim.

Në këto suaza janë formuar edhe komisione të veçanta për mbrojtje nga diskriminimi, siç është **KOMISIONI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI**.

Çështjen e avancimit të gruas në jetën publike, e në veçanti pjesëmarrjen e saj në institucionet kyçe të shoqërisë, shumë shtete fqinje, por edhe më gjerë kanë shënuar më tepër progres në krahasim me ne. Kështu për shembull:

- **Shqipëria para disa viteve ishte shteti që në vendin kyç, në krye të ligjvënësit ishte zgjedhur femra e parë, znj. Topalli.**
- **Në R. e Kosovës, para pak kohësh, as edhe një vjet, në krye të shtetit kosovar qëndronte znj. Jahjaga.**

---

<sup>8</sup> Shih Osmani, Afrim (2015) "Kodi penal i Republikës së Maqedonisë (teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe, me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik), f.138.

- Në Kroaci, në krye të shtetit gjendet znj. Kolinda Grabar-Kitarović
- Në krye të Gjermanisë gjendet kancelarja znj. Merkel
- Në krye të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri gjendet znj. Federika Mogherini.
- Rasti më i freskët është kandidatja për kryetar të super fuqisë më të madhe në botë, SHBA, është znj. Klinton.

Madje, përqindjet më të larta të grave anëtare të Parlamentit Evropian i ka Holanda, ku gratë përfshihen në 52%, Estonia me përqindje të barabartë 50%. Në Suedi, numri i grave deputete arrin tek 45%. Kurse në skajin tjetër, Malta dhe Qipro, shënojnë përqindje minimale.

Në disa vende, drejtimi i Parlamentit iu besua politikanëve femra (Kroacia 1993, Polonia 1997, Çekia 1998, Serbia 2008, Rumania 2008, Bosnja 2009, Bullgaria 2009).

### 3. REPUBLIKA E MAQEDONISË

Republika e Maqedonisë kremtoi 25 vjetorin e pavarësisë së saj, e me këtë rast ajo festoi edhe përpjekjet 25 vjeçare për të ndërtuar një shoqëri demokratike dhe të barabartë. Shoqëri në të cilën të gjithë qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve, në dokumentet e shkruara, por edhe në praktikë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, fetare, sociale dhe gjeografike. Mirëpo, fatkeqësisht që nga pavarësia e këndej, në RM-së as që i është dhënë ndonjë mundësi të tillë femrës të udhëheq me tre funksionet kryesore në shtet, kryetarit të shtetit, kryetarit të qeverisë apo kryetarit të parlamentit.

Më lejoni që të bëj prezantimin e përfaqësimit adekuat gjinor në institucionet kyçe vendimmarrëse në vend, edhe atë: në parlament; në ekzekutiv; në gjyqësor dhe prokurori; në pushtetin lokal; në polici, etj.

#### PARLAMENTI I RM-së

Sipas përbërjes së fundit të parlamentit republikan, gjendja e barazisë gjinore qëndron:

- prej gjithsej 123 deputetëve, vetëm 42 janë femra. Pra është i respektuar 30% ligjor. Por në zgjedhjet e ardhshme parlamentare kjo përqindje sipas dispozitave ligjore të kodit zgjedhor pritet të rritet në 40%.

### **QEVERIA E RM-së**

Sipas përbërjes aktuale qeveria numëron gjithsej 26 anëtarë, edhe atë:

**Kryeministri dhe 5 zv/kryeministra dhe 20 ministrat, prej të cilëve vetëm 4 ministre janë femra.**

### **PUSHTETI VENDOR në RM-së**

Republika e Maqedonisë aktualisht numëron:

**- 81 komuna gjithsej, në krye të të cilave vetëm 4 prej tyre udhëhiqen nga gjinia femërore.**

### **KËSHILLI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL**

Edhe në krye të këshillit gjyqësor edhe të atij prokurorial gjenden personat e gjinisë mashkullore.

### **PUSHTETI GJYQËSOR**

Në pushtetin gjyqësor në Republikën e Maqedonisë, në periudhën raportuese 2006-2010 e këndeje shënohet trend pozitiv i pjesëmarrjes së gjykatëseve të zgjedhura - gra në mënyrë të barabartë me gjykatësit e zgjedhur - burra. Në të njëjtën periudhë, më shumë se gjysma e gjykatësve të zgjedhur janë gra. Ja se si qëndron gjendja momentale e përfaqësimit gjinor nëpër gjykata dhe prokurori:

- **Prej gjithsej 27 gjykata themelore – vetëm 5 prej tyre janë femra.**
- **Prej gjithsej 4 gjykata të apelit – 2 prej tyre janë femra.**
- **Në krye të gjykatës së shkallës së fundit, gjykatës supreme gjendet person i gjinisë femërore.**
- **Në krye të gjykatës administrative gjendet person i gjinisë femërore.**
- **Në krye të gjykatës së lartë administrative gjendet person i gjinisë femërore.**
- **Në krye të gjykata kushtetuese gjendet person i gjinisë femërore.**
- **Në krye të prokurorisë republikane person i gjinisë mashkullore.**
- **Prej gjithsej 4 prokurorive të larta – asnjë femër.**
- **Prej gjithsej 23 prokurorive themelore – vetëm 3 prej tyre janë persona të gjinisë femërore.**

- Në krye të prokurorisë speciale gjendet person i gjinisë femërore, znj. Janeva

### **SEKTORËT E PUNËVE TË BRENDSHME PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

Sa femra janë zgjedhur në krye me sektorët e punëve të brendshme? Edhe pse më herët në krye të MPB gjendej person i gjinisë femëror, por nuk u ndërmor shumë që të përmirësohet situata me përfaqësimin e femrës në këtë institucion. Sidoqoftë, aktivitetet dhe veprimtarinë e punëve të brendshme e kryejnë sektorët, të cilët gjithsej janë 8 në tërë territorin e RM-së, e që asnjë nuk drejtohet nga personat e gjinisë femërore.

### **Partitë politike në RM-së**

Diskriminim gjinor, RM-së shënon edhe në partitë politike, prej mbi 30 parti politike, në krye të cilëve vetëm 1 prej tyre udhëhiqet nga person i gjinisë femërore, Përtëritja Demokratike e Maqedonisë e znj. Popovska.

### **Pse duhet rritur pjesëmarrja e gruas në institucionet shtetërore dhe jetën publike?**

Meqë si rezultat i proceseve dhe zhvillimeve ekonomiko-sociale, juridiko-politike, femra gjithnjë e më tepër bëhet pjesë përbërëse e këtyre proceseve dhe bartëse e detyrimeve që dalin nga këto, duke filluar nga biznesi, ekonomia, tregtia, arsimi, kultura, mjekësia, po ashtu edhe në kriminalitet. Andaj, femra duhet të jetë bartëse e institucioneve vendimmarrëse.

## **4. CONCLUSION**

One of the main reasons contributing to marginalization of women in public life is the lack of political will of the party leadership to put female candidates on their lists and make selection for management personnel with relevant institutions in society.

Although 40 to 50 percent of party members in the world are women, women have only 10 percent of management posts within these parties. To ensure equal participation of women in decision-making

structures of parties is necessary to promote gender equality within them - as well as within society as a whole.

According to a study, the representation of women in leadership positions and decision-making roles continues to be a widespread global challenge. This problem is not limited to developing countries; in fact, this is a widespread international phenomenon. Women occupy only 18% of seats in parliaments and 16% of ministerial positions in the world. Thus, the percentage of women who act as heads of state and government official is very low, only 5% in 2011. Globally, women are inadequately represented in decision-making positions and other positions of power, responsibility and leadership, regardless of the increase level of formal employment of women decades.

Although Balkan societies have consistently made efforts to achieve gender equality, in particular the advancement of women in society and public life, yet there is much to do to achieve this goal. So the challenge for the future is still advancing the position of women in society and public life.

#### **4. LITERATURA**

Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit, Raport mbi procesin e punës dhe vendimmarrjes, mars 2012 <http://abgj.rks-gov.net/sqal/departamente/raportedhehulumtime.aspx>

Bardan, Margot (2012) KONTESTIMI I IDENTITETEVE FEMËRORE, FEMINISTE DHE MUSLIMANE / Kontestet post-socialiste në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Sarajevo.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

Lobi maqedonas i grave (2012) POLITIKA PËR BARAZI GJINORE- PERCEPTIMI I EFIKASITETIT DHE TRANSPARENCËS, Shkup.

Osmani, Afrim (2015) “Kodi penal i Republikës së Maqedonisë (teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe, me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik), Furkan ISM, Shkup.



## CENTRUM 6

---

Pollozhani, dr. Bajram (2011), “Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës”, Furkan ISM, Shkup

Republika e Kosovës, Republika Kosova-Republic of Kosovo, Qeveria - Vlada – Government ZYRA E KRYEMINISTRIT// OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/AGENCY OF GENDER EQUALITY, Tetor 2014, Prishtinë

Zogjani, Valëza (2013), Hulumtim: Pozita e femrave në procesin e vendimmarrjes në Kosovë, Prishtinë.

II-REKOMANDIME PËR DISA MASA TË POSACME NË KODIN ZGJEDHOR, PËR RRITJEN E PJESËMARRJES SË GRAVE NË ORGANET E ZGJEDHURA, a.d.